



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Kadastrit në Prishtinë
Periudha raportuese	Muaji, Korrik 2018
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Nora Kelmendi, Drejtore e Drejtorisë së Kadastrit

1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Drejtoria e Kadastrit - Zyra kadastrale komunale (ZKK) e Prishtinës ka vazhduar të bëjë ofrimin e shërbimeve sa me efikase për qytetar duke ofruar informacione dhe të dhëna të azhurnuara për pronat e paluajtshme.

Gjatë muajit **korrik** në **6** zyrat pritëse janë pranuar gjithsej **3,386** kërkesa nga të cilat janë aprovuar **3262** kërkesa, refuzuar **32** kërkesa dhe kanë mbetur në procedurë edhe **92** kërkesa, të cilat janë realizuar përmes **2 sektorëve**: sektorit të Kadastrit dhe sektorit të Gjeodezisë.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me plan programin e Komunës për drejtorinë tuaj .

Aktivitetet e planifikuara të drejtorisë së Kadastrit janë:

- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim të pronësisë
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim dhe çregjistrim të hipotekës
- Shqyrtimi i kërkesave për përmirësim të regjistrave kadastral
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim të banesave
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve.
- Shqyrtimi i kërkesave për ndarje të pronësisë, parcelave
- Shqyrtimi i kërkesave për dhënien e produkteve (koordinatave)
- Shqyrtimi i kërkesave për bashkim të parcelave
- Shqyrtimi i kërkesave për identifikimin e njërive banesore
- Shqyrtimi i kërkesave për përcaktim dhe ri-rregullim kufiri
- Shqyrtimi i kërkesave nga gjeometër dhe kompanitë e licencuara
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve.

3. *AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.*

Në Drejtorinë e Kadastrit në Prishtinë gjatë muajit Korrik 2018 nëpërmes zyrave pritëse dhe 2 sektorëve, atij të Kadastrit dhe gjeodezisë janë pranuar kërkesa të ndryshme prej të cilave:

Në sektorin e Kadastrit janë përpunuar kërkesat në vijim:

- 305 kërkesa për regjistrim të pronësisë prej të cilave janë aprovuar 243, janë refuzuar 17 kërkesa për regjistrim të pronësisë, ndërsa janë njoftuar palët në procedurë me 45 konkluzione duke u pezulluar procedura deri në plotësimin e lëndëve me dokumentacione përkatëse.
- 7 kërkesa për historiate nga persona fizik, institucione prej të cilave janë aprovuar 5, nuk është refuzuar asnjë, ndërsa në procedurë kanë mbetur edhe 2 kërkesa për përpunim.
- 266 shkresa / kërkesa nga Institucionet e ndryshme prej të cilat janë aprovuar 217, janë refuzuar 13 dhe në procedurë kanë mbetur edhe 36 kërkesa.
- 17 kërkesa për përmirësime nga të cilat janë aprovuar 10, janë refuzuar 2 dhe 5 kërkesa kanë ngelur në procedurë për shqyrtim.
- 3 kërkesa nga ATK – ja, për vendosje regjistrim të barrës tatimore - të regjistruara të gjitha.
- 3 kërkesa nga ATK – ja, për lirim të barrës tatimore të regjistruara të gjitha.
- 69 kërkesa për regjistrim të hipotekave prej të cilave janë aprovuara të gjitha, si dhe 45 kërkesa për çregjistrim të hipotekave prej të cilave janë aprovuar 41 dhe 4 kanë mbetur në procedurë për plotësim dokumentacioni.

Totali i kërkesave të pranuar për këtë sektor ka qenë: 715 nga të cilat 591 kërkesa janë aprovuar, 32 janë refuzuar dhe 92 kërkesa kanë ngelur në procedurë për shqyrtim.

Në sektorin e gjeodezisë janë përpunuar kërkesat në vijim:

- 1,439 kërkesa për certifikata të pronësisë dhe 1,034 kërkesa për kopje të planit – të realizuara të gjitha brenda ditës së aplikimit.
- 6 kërkesa për bashkim të parcelave - të aprovuara të gjitha.
- 53 kërkesa për dhënie e produkteve (koordinatave) - të realizuar të gjitha.
- 47 kërkesa për identifikimin e njësive banesore nga të cilat janë aprovuar të gjitha.
- 23 kërkesa për përcaktim dhe ri-rregullim kufiri nga të cilat janë aprovuar të gjitha.
- 40 kërkesa nga gjeodetët dhe kompanitë e licencuara nga të cilat janë aprovuar të gjitha.
- 8 kërkesa për ndërrim të kulturës së tokës nga ajo bujqësore në ndërtimore.
- 21 kërkesa zyrtare për përmirësime nga palët dhe kërkesa zyrtare nga institucionet si: Ministria e Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Urbanizimit, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Agjencia Kosovare e Pronës (KPA) etj., nga të cilat janë aprovuar të gjitha. Verbërve, Ndërmarrja Publike Banesore, Agjencia Kosovare e Pronës (KPA) etj, dhe të cilat janë aprovuar në tërësi.

Totali i kërkesave të pranuar për këtë sektor ka qenë: 2,671 nga të cilat janë aprovuar të gjitha.

Nga të dhënat e lartshënuara shihet se drejtoria e Kadastrit ka implementuar gati **96** për qind (%) të planit të saj duke i aprovuar, refuzuar dhe pezulluar kërkesat e palëve në procedurë sipas shqyrtimeve ligjore që ka bërë lidhur me këto kërkesa.

E arritur e kësaj Drejtorie është që në afatin e përcaktuar ligjor prej 15 ditëve ka arritur të nxjerr vendime meritore për secilën prej kërkesave të parashtruara nga palët /subjektet juridike.

4. *AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.*

Nga sektori i Kadastrit aktivitetet të cilat janë në implementim e sipër janë:

- Lëndët në shpallje publike në afat prej **5** ditë punë që kanë të bëjnë me regjistrimin e pronës së paluajtshme në operatin kadastral.
- Lëndët e dërguara në KPA verifikim dhe pëlqime për regjistrim të banesave.
- Lëndët e dërguara për verifikim në gjykata, arkiv komunal ose ndër komunal.

Nga sektori i gjeodezisë aktivitetet të cilat janë në implementim e sipër janë:

- Lëndët për ndarje, identifikim dhe bashkim të parcelave.
- Lëndët për identifikimin e njësive banesorë.
- Lëndët për kërkesa zyrtare dhe kërkesa nga institucionet.

4.1.1. *STATISTIKAT-Të listohen te gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të këtë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.*

Kërkesat e pranuar në drejtorinë e Kadastrit muaji Korrik 2018	Numri total i kërkesave	Të aprovuara	Të refuzuara	Në procedurë	Mjetet e grumbulluara €
Certifikata të pronësisë & Kopje të planit	2,473	2,473	0	0	11,760
Kërkesa për RDPP (regjistrimi i të drejtës për pronë të paluajtshme)	305	243	17	45	11,102
Kërkesa për historiate zyrtare, historiate për persona fizik dhe juridik	7	5	0	2	150
Kërkesa nga Institucionet e ndryshme dhe përgjigjet nga Gjykata dhe Institucione të tjera - Shërbimi i RDPP-së	266	217	13	36	255
Përmirësime në RDPP	17	10	2	5	340
Vendosje të barrës tatimore	3	3	0	0	90
Lirim nga barra tatimore	3	3	0	0	30
Kërkesat për regjistrim të hipotekave	69	69	0	0	7,590
Kërkesat për çregjistrim të hipotekave dhe ndryshime	45	41	0	4	450
Ndarjet - parcelimet	0	0	0	0	0
Bashkimi i parcelave	6	6	0	0	180
Dhënia e produkteve - pikave kadastrale (koordinatave)	53	53	0	0	1,180
Identifikimi i parcelave dhe njësisve banesore	47	47	0	0	940
Përcaktimi dhe ri-rregullimi i kufirit të parcelave	23	23	0	0	580
Kërkesat me licencë	40	40	0	0	1,847
Kërkesa zyrtare nga institucionet - Shërbimi i gjeodezisë	21	21	0	0	44.00
Ndërrimi i Kulturave të parcelave	8	8	0	0	29,715
Totali	3,386	3,262	32	92	66,253

4.1.2 Buxhetin e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese

Drejtoria e Kadastrit nuk shpenzon buxhet për të regjistruar të drejtat pronësore në regjistrat kadastral përkundrazi kjo drejtori realizon të hyra nga taksat e qytetarëve.

4.1.3 Takimet me palë

- **Sektori i kadastrit** - gjegjësisht zyra për regjistrimin e pronës së paluajtshme (RDPP) ka takime të rregullta me palë **dy herë në javë (e martë, e enjte)** nga 2 orë në ditë me dy zyrtar ligjor ku ofrohen këshilla për plotësim të lëndëve sipas kërkesave të palës. Brenda këtyre 2 ditëve, 2 zyrtarët e Zyrës për RDPP takohen përafërsisht me nga 370 qytetar.
- **Sektori i gjeodezisë** - ka takime të rregullta me palë **dy herë në javë (e mërkurë dhe e premte)** nga 2 orë ku gjatë muajit korrik ka pranuar 281 palë për plotësim të lëndëve sipas kërkesave të tyre për ndarje, bashkim ose rregullim kufiri. Po ashtu ka takime me palë për identifikimin e banesave si dhe takime të tjera me palë sipas kërkesave të tyre lidhur me çështjet pronësore.

5. Takimet me institucione të tjera

Në fillim të muajit Korrik së bashku me drejtorin e Administratës jemi takuar me Kryeshefin e Agjencionit Kadastral të Kosovës Z. Murat Meha, dhe jemi dakorduar që bashkërisht të formojmë ekipin i cili do të punoj në instalimin e programit për printim të Certifikatave të Pronës dhe Kopjeve të Planit në E-Kiosqet të cilat gjinden në Komunë të Prishtinës.

Po ashtu, kemi pas takime edhe me zyrtarë të tjerë të Policisë së Kosovës (Polic Hetues) , Zyrtarë të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Zyrtarë të Agjencionit Kadastral të Kosovës etj., lidhur me lëndët në procedurë dhe çështje tjera.

5.1.1 Diskutime Publike / Takimet me qytetarë – kemi mbajtur 2 dëgjime publike buxhetore të përgjithshme me qytetarë me datë 16 dhe 20 Korrik 2018.

6. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare – nuk kemi pas kërkesa.

6.1.1 Lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër

- Sektori i Kadastrit:

- Lëndë të pranuar: **715**
- Lëndë të aprovuara: **591**
- Lëndë të refuzuara: **32**
- Lëndë në procedurë: **92**

- Sektori i Gjeodezisë:

- Lëndë të pranuar: **2,671**
- Lëndë të aprovuara: **2,671**
- Lëndë të refuzuara:
- Lëndë në procedurë:

Takime të tjera - nuk ka.

7. *SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda drejtorisë, komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.*

Spektori i Kadastrit:

- Sfiduese është komunikimi me institucionet, mos përgjigjet e tyre në afate ligjore të cilat na krijojnë probleme me palë dhe përfaqësues të palëve.
- 7 kërkesa presin për - Verifikime në Arkiv Komunal dhe Nder komunal
- 46 kërkesa presin për Verifikime në Gjykatë
- 4 kërkesa presin për Verifikime në Privatizim
- 7 kërkesa presin për Verifikime në NPB
- 7 kërkesa presin për Verifikime në KPA

Spektori i gjeodezisë:

- Sfiduese është komunikimi me Agjencinë Kadastrale të Kosovës, mos përgjigjet e tyre në lidhje me problemet që hasim çdo ditë me **programin e Hartës Kadastrale** dhe **SIKTK** të cilat na krijojnë probleme me palë dhe përfaqësues të palëve.
- Mungesa e shënimeve në pjesën grafike, gabimet të cilat janë krijuar me rastin e rikonstruimit të disa zonave kadastrale nga Agjencia Kadastral e Kosovës.

8. **REKOMANDIME** - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve nëse keni dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shtesë, etj.

Spektori i Kadastrit dhe Gjeodezisë: Trajnime për zyrtarë sa i përket administratës dhe funksionimit të saj.

9. **AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES** -Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues

Spektori i Kadastrit:

- Lëndët në shpallje publike në afat prej 5 ditë punë.
- Lëndët në KPA për pëlqime për regjistrim të banesave.
- Lëndët për verifikim në gjykata, NPB, AKP, arkiv komunal ose ndër komunal.

Spektori i Gjeodezisë:

- Shqyrtimi i kërkesave për ndarje të pronësisë
- Shqyrtimi i kërkesave për dhënien e produkteve (koordinatave)
- Shqyrtimi i kërkesave për bashkim të parcelave
- Shqyrtimi i kërkesave për identifikimin e njësive banesore
- Shqyrtimi i kërkesave për përcaktim dhe ri-rregullim kufiri
- Shqyrtimi i kërkesave për gjeodetët apo kompanitë e licencuara
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve.

10. **TË TJERA** - Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme